www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE

## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 51

**Tiranë – E hënë, 6 prill 2015**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 30/2015 datë 2.4.2015 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar | 2167 |
| Dekret i Presidentit nr. 9041, datë 6.4.2015 | Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit | 2170 |
| Ligj nr. 31/2015 datë 2.4.2015 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar | 2171 |
| Dekret i Presidentit nr. 9042, datë 6.4.2015 | Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit | 2181 |

# LIGJ
# Nr. 30/2015

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8652, DATË 31.7.2000, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 13, 81, pika 2, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 108-115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, fjalët "komunë", "kryetar komune" e "këshilli i komunës" hiqen.

Neni 2

Në nenin 2, pas pikës 15 shtohet pika 16 me këtë përmbajtje:

"16. "Konsultimi" ndërmjet institucioneve të pushtetit qendror dhe njësive të qeverisjes vendore është një proces institucional, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin dhe shkëmbimin e opinioneve për politikat, legjislacionin e normat që rregullojnë qeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.".

Neni 3

Në nenin 4, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të qeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimin e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.".

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5
**Përcaktimi: bashki, qark dhe nënndarjet**

1. Bashkia është njësi bazë e qeverisjes vendore.

2. Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh. Bashkitë, shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj përcaktohen me ligj.

3. Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj.

4. Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj. Shpallja e qyteteve të reja bëhet me ligj.

5. Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Një lagje mund të krijohet vetëm në territore, që si rregull kanë mbi 20 mijë banorë. Ndarja e qyteteve në lagje dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

6. Qarku është njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore.

7. Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj.".

Neni 5

Në nenin 8, pika 1, pas nënndarjes "V" shtohet nënndarja "V/1" me këtë përmbajtje:

"V/1. E drejta e konsultimit

a) Njësitë e qeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave të të zgjedhurve vendorë dhe grupeve të tjera të interesit, në kohën dhe mënyrën e duhur, që u mundëson prezantimin e opinioneve dhe propozimeve të tyre për politikat dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.

b) Procesi i konsultimit zhvillohet sipas procedurave dhe brenda kuadrit të një strukture të përcaktuar. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për hartimin e akteve nënligjore që përcaktojnë strukturën, formën, mënyrën e organizimit, funksionimin, natyrën e çështjeve për konsultim dhe frekuencën kohore të procesit të konsultimeve.”.

Neni 6

Në nenet 15, pika 5, dhe 19, pikat 4, 5, 8 e 9, fjalët “ligjin nr. 8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”,” zëvendësohen me fjalët “legjislacionin në fuqi që rregullon menaxhimin e sistemit buxhetor dhe financave vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24
**Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak**

1. Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| **-Bashkitë** | **deri në 20 000 banorë** | **15 anëtarë;** |
| **-Bashkitë** | **nga 20 001 deri në 50 000 banorë** | **21 anëtarë;** |
| **-Bashkitë** | **nga 50 001 deri në 100 000 banorë** | **31 anëtarë;** |
| **-Bashkitë** | **nga 100 001 deri në 200 000 banorë** | **41 anëtarë;** |
| **-Bashkitë** | **nga 200 001 deri në 400 000 banorë** | **51 anëtarë;** |
| **-Bashkitë** | **mbi 400 000 banorë** | **61 anëtarë.** |

2. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet.”.

Neni 8

Në nenin 32, shkronjat “ç” dhe “dh” ndryshohen si më poshtë:

“ç) Miraton nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

dh) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.”.

Neni 9

Në nenin 35, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Aktet e këshillit afishohen në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për njoftimin e konsultimin publik, si dhe me rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.”.

Neni 10

Në nenin 39, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo bashki ka kryetarin e saj, të zgjedhur çdo katër vjet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë, sipas mënyrës së parashikuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 11

Në nenin 44 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse, të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kërkohet nga këshilli.”.

2. Shkronja “f” ndryshohet si më poshtë:

“f) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë jodrejtues të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në legjislacionin në fuqi për nëpunësit civilë;”.

3. Pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “i” dhe “j” me këtë përmbajtje:

“i) miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;

j) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive administrative/lagjeve.”.

Neni 12

Titulli i kreut VIII ndryshohet dhe zëvendësohet me titullin “Drejtimi dhe funksionimi i njësisë administrative”.

Neni 13

Në fillim të kreut VIII, para nenit 45 shtohen nenet 44/1 dhe 44/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 44/1
**Administrata e njësisë administrative**

1. Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori.

2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës. Administratori duhet të ketë vendbanimin në njësinë administrative përkatëse.

3. Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative, është pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Neni 44/2
**Detyrat e administratës së njësisë administrative**

1. Administrata e njësisë administrative brenda juridiksionit të caktuar territorial kryen këto detyra:

a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;

b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;

c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;

ç) bazuar në vendimin e këshillit të bashkisë mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;

d) bazuar në vendimin e këshillit të bashkisë mund të administrojë tregjet publike;

dh) bazuar në vendimin e këshillit të bashkisë mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;

e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre sipas ligjit;

ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;

f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve dhe kryesive të fshatrave;

g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;

gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit brenda juridiksionit të saj territorial;

h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari apo këshilli i bashkisë.

2. Administratori i njësisë administrative është organi kompetent për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, të përcaktuara si të tilla me akte të këshillit bashkiak, brenda juridiksionit të caktuar territorial.

3. Administratori mund t'i delegojë kompetencën e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nëpunësve të administratës në varësi.".

Neni 14

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me titullin "Drejtimi i fshatit".

2. Pikat 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

"4. Zgjedhjet e kryesisë dhe të kryetarit të fshatit bëhen një herë në katër vjet pas zgjedhjeve për këshillin bashkiak dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve.

5. Në rastet e krijimit të vendit vakant për kryetarin e fshatit ose për anëtar të kryesisë zhvillohen procedurat e mësipërme të zgjedhjes për vendin vakant. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të afatit katërvjeçar.".

Neni 15

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me titullin "Administrimi i lagjes".

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Në rastin e krijimit të lagjeve, sipas pikës 5, të nenit 5, të këtij ligji, në secilën lagje krijohet dhe funksionon administrata e lagjes, që drejtohet nga administratori i lagjes. Administratori i lagjes emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë. Nëpunësit e tjerë të administratës trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.".

Neni 16

Neni 48 shfuqizohet.

Neni 17

Në nenin 50, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

"1. Numri i përfaqësuesve të bashkive në këshillin e qarkut caktohet në përpjesëtim me numrin e popullsisë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| - Bashkitë me popullsi deri në 20 000 banorë | 2 përfaqësues. |
| - Bashkitë me popullsi 20 001 deri në 50 000 banorë | 4 përfaqësues. |
| - Bashkitë me popullsi 50 001 deri në 100 000 banorë | 5 përfaqësues. |
| - Bashkitë me popullsi mbi 100 000 banorë | 5 + nga një përfaqësues shtesë për çdo 1 deri në 50 000 banorë mbi 100 000 banorë. |

2. Brenda numrit të përfaqësuesve për çdo bashki, sipas pikës 1, përfshihet kryetari i bashkisë, si dhe përfaqësuesit e tjerë që zgjidhen nga këshilli i bashkisë.".

Neni 18

Në nenin 58, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Kryesia e këshillit të qarkut përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe nga 3 deri në 5 anëtarë të tjerë.".

Neni 19

Në nenin 60, shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

"dh) emëron dhe shkarkon personelin e administratës së këshillit të qarkut, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në legjislacionin në fuqi për nëpunësit civilë.".

Neni 20

Në nenin 70, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Procedurat dhe masat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër shtetëror në njësitë e qeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 21

Pas nenit 75 shtohen nenet 75/1 dhe 75/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 75/1

Organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituuara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial, sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.

Neni 75/2

Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësive administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësive administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative.".

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 2.4.2015

**DEKRET**
**Nr. 9041, datë 6.4.2015**

## PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjin nr. 30/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar".

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 30/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar".

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bujar Nishani**

**LIGJ**
**Nr. 31/2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Fjalia e parë dhe e dytë e pikës 2 ndryshohen si më poshtë:

"2. Juridiksioni territorial i ZAZ-ve, si rregull, është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë, sipas ligjit që rregullon organizimin administrativ-territorial të Republikës së Shqipërisë. Bashkitë që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote ndahen nga KQZ-ja në më shumë sesa një Zonë të Administrimit Zgjedhor, në përputhje me kriteret e mëposhtme:"

b) Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) pandashmëria e territorit të njësisë administrative, përjashtuar ato me më shumë se 80 mijë zgjedhës;"

2. Në pikën 3, togfjalëshi "apo rrethe të ndryshme brenda të njëjtit qark", hiqet.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Për Bashkinë e Tiranës, secila nga njësitë bashkiake përbën Zonë Administrimi Zgjedhor më vete."

4. Në pikën 5, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

"Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore dhe njësive administrative të përfshira në to.".

5. Në pikën 6, fjalët "sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni" zëvendësohen me fjalët "sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni".

Neni 2

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet shkronja "f" me këtë përmbajtje:

"f) gjinia".

2. Në pikën 2, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Lista që përdoret nga KQV-ja në procesin e votimit përmban përbërësit e përcaktuar në shkronjat "a", "ç", "d", "dh" dhe "f", të pikës 1, të këtij neni.".

Neni 3

Në nenin 48 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve "zonës zgjedhore" shtohen fjalët "njësinë e qeverisjes vendore, njësinë administrative".

2. Në pikën 2, shkronjat "b" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"b) listë zgjedhësish në formë të printuar për përdorim nga KQV-ja në procesin e votimit, e ndarë sipas qendrave të votimit dhe që përmban përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat "a", "ç", "d", "dh" dhe "f", të pikës 1, të nenit

45. Ky format përmban edhe hapësirën për shënimin e numrit të dokumentit të identifikimit dhe nënshkrimin nga vetë zgjedhësi gjatë votimit;

c) përmbledhje e të gjithë zgjedhësve në formë elektronike, printuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në nivel zone të administrimit zgjedhor, sipas llojit të zgjedhjeve, me përbërësit zgjedhorë, të përmendur në shkronjën "a", të këtij neni, i cili përdoret nga KZAZ-ja për informim të zgjedhësve;".

Neni 4

Në nenin 62, pika 8 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 67 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Në zbatim të paragrafit të dytë, të pikës 1, dhe paragrafit të dytë, të pikës 2, të këtij neni, kandidati për kryetar bashkie dhe listat për këshillin e bashkisë, territori i të cilave nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, regjistrohen në KQZ.".

2. Në fund të pikës 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas paragrafit të dytë, të pikës 2, të nenit 164, të këtij Kodi.".

Neni 6

Në nenin 94 bëhen këto ndryshime:

1.Në pikën 1, fjalët "bashkinë qendër rrethi" zëvendësohen me fjalët "bashkinë qendër qarku".

2. Fjalia e parafundit e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"Një vend numërimi votash nuk mund të ketë më pak se 3 dhe më shumë se 10 tavolina numërimi.".

Neni 7

Në nenin 97, pika 3 shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 104, pika 3 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 116, fjalia e dytë e pikës 1 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 120 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"Për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor, KZAZ-ja i vendos kutitë e votimit të grupuara, sipas organit përkatës.".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Për çdo bashki, numërimi fillon me votat për kryetarin dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin përkatës.".

Neni 11

Në nenin 122 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Në rast të zgjedhjeve vendore, KZAZ-ja miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të bashkisë. Në rastet kur territori i bashkisë nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, çdo KZAZ miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për atë pjesë të territorit të bashkisë. Në çdo rast KZAZ-ja zbaton të njëjtat kritere dhe procedura të përshkruara në këtë nen. Vendimi ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi.".

2. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Kopja origjinale e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të KZAZ-së dhe Tabelat e Rezultateve për çdo qendër votimi i dërgohen KQZ-së për të nxjerrë rezultatin, sipas nenit 123 të këtij Kodi.".

Neni 12

Në nenin 164, në pikën 2, pas fjalëve "Mandati i ndërprerë" shtohen fjalët "i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë".

Neni 13

Në nenin 175, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Mospërmbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6, të nenit 67, të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1 000 000 lekë si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të

këtij neni, në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin, dhe me refuzimin e listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor.”.

Neni 14

Neni 177 shfuqizohet.

Neni 15

Neni 180 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 180
**Ndarja e zonave të administrimit zgjedhor**

Për zgjedhjet e vitit 2015 për organet e qeverisjes vendore, zonat e administrimit zgjedhor përcaktohen në Aneksin 1 të këtij Kodi, bazuar në numrin e zgjedhësve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.”.

Neni 16

Pas nenit 180 shtohet neni 180/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 180/1

Për zgjedhjet e vitit 2015 për organet e qeverisjes vendore, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në Pjesën III “Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve” të këtij Kodi, për Bashkinë e Tiranës do të kryhen nga kryetarët e njësive bashkiake të Tiranës.”.

Neni 17

Në nenin 184, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Përjashtimisht për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, afatet e parashikuara në nenin 28 e në vijim të Kodit Zgjedhor, të cilat nuk mund të zbatohen, ngarkohet KQZ-ja për miratimin e tyre me vendim, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji.”.

Neni 18

Në të gjithë tekstin e ligjit, fjalët “komunë”, “kryetar komune”, “këshill komune”, hiqen.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 2.4.2015

Aneksi 1

ZONAT E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

| Nr. | Qarku | Nr. | Bashkia | Nr. | Njësia admnistrative | Zgjedhës njësi | Zgjedhës ZAZ | ZAZ Nr |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkodër | 1 | MALËSI E MADHE | 1 | Koplik | 8,489 | 42,556 | 01 |
| | | | | 2 | Gruemirë | 10,205 | | |
| | | | | 3 | Kastrat | 9,711 | | |
| | | | | 4 | Kelmend | 5,102 | | |
| | | | | 5 | Qendër | 4,622 | | |
| | | | | 6 | Shkrel | 4,427 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 2 | SHKODËR | 7 | Ana e Malit | 4,610 | 67,689 | 02 |
| | | | | 8 | Bërdicë | 7,245 | | |
| | | | | 9 | Dajç | 7,035 | | |
| | | | | 10 | Guri i Zi | 8,619 | | |
| | | | | 11 | Postribë | 8,216 | | |
| | | | | 12 | Pult | 2,250 | | |
| | | | | 13 | Shosh | 963 | | |
| | | | | 14 | Rrethinat | 17,366 | | |
| | | | | 15 | Shalë | 4,222 | | |
| | | | | 16 | Velipojë | 7,163 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 17 | Shkodër (zona QV 0235 deri 0245, zona QV 0269, zona QV 0279, zona QV 0280, zona QV 0282, zona QV 0284, zona QV 0286 deri 0297 dhe zona QV 0299 deri 0304) | 91,021 | 31,029 | 03 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Shkodër (zona QV 0246 deri 0263, zona QV 0265 deri 0268, zona QV 0270, zona QV 0276, zona QV 0316, zona QV 0318, zona QV 0319 dhe zona QV 0321) | | 30,472 | 04 |
| | | | | | Shkodër (zona QV 0271 deri 0275, zona QV 0277, zona QV 278, zona QV 281, zona QV 0283, zona QV 0285, zona QV 0298, zona QV 0305 deri 0315, zona QV 0317, zona QV 0320, zona QV 0322 dhe zona QV 0323) | | 29,520 | 05 |
| | | | | | | | | |
| | | 3 | VAU-DEJËS | 18 | Vau-Dejës | 8,677 | 36,276 | 06 |
| | | | | 19 | Temal | 1,532 | | |
| | | | | 20 | Bushat | 18,148 | | |
| | | | | 21 | Hajmel | 4,972 | | |
| | | | | 22 | Vig-Mnelë | 1,660 | | |
| | | | | 23 | Shllak | 1,287 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 4 | PUKË | 24 | Pukë | 4,047 | 12,717 | 07 |
| | | | | 25 | Rrapë | 1,276 | | |
| | | | | 26 | Gjegjan | 3169 | | |
| | | | | 27 | Qerret | 2,456 | | |
| | | | | 28 | Qelëz | 1,769 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 5 | FUSHË-ARRËZ | 29 | Fushë-Arrëz | 3,536 | 8,951 | 08 |
| | | | | 30 | Blerim | 992 | | |
| | | | | 31 | Qafë-Mali | 1,435 | | |
| | | | | 32 | Fierzë | 1,539 | | |
| | | | | 33 | Iballë | 1,449 | | |
| | | | | | | | | |
| 2 | Kukës | 6 | TROPOJË | 34 | Bajram Curri | 6,412 | 21,532 | 09 |
| | | | | 35 | Bujan | 2,202 | | |
| | | | | 36 | Bytyc | 1,556 | | |
| | | | | 37 | Fierzë | 1,844 | | |
| | | | | 38 | Lekbibaj | 1,439 | | |
| | | | | 39 | Llugaj | 1,655 | | |
| | | | | 40 | Margegaj | 2,313 | | |
| | | | | 41 | Tropojë | 4,111 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 7 | HAS | 42 | Krumë | 5,360 | 15,275 | 10 |
| | | | | 43 | Gjinaj | 1,058 | | |
| | | | | 44 | Golaj | 5,890 | | |
| | | | | 45 | Fajza | 2,967 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 8 | KUKËS | 46 | Kukës | 16,518 | 43,326 | 11 |
| | | | | 47 | Kolsh | 985 | | |
| | | | | 48 | Bicaj | 4,360 | | |
| | | | | 49 | Ujmisht | 1,612 | | |
| | | | | 50 | Bushtricë | 1,205 | | |
| | | | | 51 | Grykë-Çajë | 1,182 | | |
| | | | | 52 | Kalis | 695 | | |
| | | | | 53 | Malzi | 2,661 | | |
| | | | | 54 | Shishtavec | 3,852 | | |
| | | | | 55 | Shtiqën | 2,536 | | |
| | | | | 56 | Surroj | 1,216 | | |
| | | | | 57 | Arrën | 366 | | |
| | | | | 58 | Tërthore | 2,310 | | |
| | | | | 59 | Topojan | 1,797 | | |
| | | | | 60 | Zapod | 2,031 | | |
| | | | | | | | | |
| 3 | Lezhë | 9 | LEZHË | 61 | Lezhë | 22,742 | 39,732 | 12 |
| | | | | 62 | Balldren | 7,820 | | |
| | | | | 63 | Shëngjin | 9,170 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| | | | | 64 | Blinisht | 4,328 | 41,535 | 13 |
| | | | | 65 | Dajç | 5,419 | | |
| | | | | 66 | Kallmet | 5,335 | | |
| | | | | 67 | Kolsh | 5,121 | | |
| | | | | 68 | Shënkoll | 12,079 | | |
| | | | | 69 | Ungrej | 2,318 | | |
| | | | | 70 | Zejmen | 6,935 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 10 | MIRDITË | 71 | Rrëshen | 11,011 | 28,444 | 14 |
| | | | | 72 | Kaçinar | 1,522 | | |
| | | | | 73 | Rubik | 6,208 | | |
| | | | | 74 | Fan | 3,444 | | |
| | | | | 75 | Kthellë | 2,410 | | |
| | | | | 76 | Selitë | 1,396 | | |
| | | | | 77 | Orosh | 2,453 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 11 | KURBIN | 78 | Laç | 22,664 | 54,782 | 15 |
| | | | | 79 | Mamurras | 16,814 | | |
| | | | | 80 | Fushë-Kuqe | 6,591 | | |
| | | | | 81 | Milot | 8,713 | | |
| | | | | | | | | |
| 4 | Dibër | 12 | MAT | 82 | Burrel | 13,195 | 29,441 | 16 |
| | | | | 83 | Baz | 2,348 | | |
| | | | | 84 | Derjan | 1,085 | | |
| | | | | 85 | Macukull | 1,381 | | |
| | | | | 86 | Komsi | 3,855 | | |
| | | | | 87 | Lis | 3,545 | | |
| | | | | 88 | Rukaj | 2,576 | | |
| | | | | 89 | Ulëz | 1,456 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 13 | KLOS | 90 | Klos | 7,679 | 15,449 | 17 |
| | | | | 91 | Gurrë | 2,835 | | |
| | | | | 92 | Suç | 2,569 | | |
| | | | | 93 | Xibër | 2,366 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 14 | BULQIZË | 94 | Bulqizë | 9,055 | 29,100 | 18 |
| | | | | 95 | Fushë-Bulqizë | 2,827 | | |
| | | | | 96 | Gjoricë | 3,734 | | |
| | | | | 97 | Martanesh | 1,826 | | |
| | | | | 98 | Ostren | 2,407 | | |
| | | | | 99 | Trebisht | 745 | | |
| | | | | 100 | Shupenzë | 4,759 | | |
| | | | | 101 | Zerqan | 3,747 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 15 | DIBËR | 102 | Peshkopi | 14,136 | 57,022 | 19 |
| | | | | 103 | Arras | 2,701 | | |
| | | | | 104 | Fushë Çidhën | 2,606 | | |
| | | | | 105 | Kala e Dodës | 2,175 | | |
| | | | | 106 | Kastriot | 5,287 | | |
| | | | | 107 | Lurë | 1,067 | | |
| | | | | 108 | Luzni | 2,168 | | |
| | | | | 109 | Maqellarë | 9,697 | | |
| | | | | 110 | Melan | 3,210 | | |
| | | | | 111 | Muhurr | 2,529 | | |
| | | | | 112 | Selishtë | 1,347 | | |
| | | | | 113 | Sllovë | 2,235 | | |
| | | | | 114 | Tomin | 6,181 | | |
| | | | | 115 | Zall-Dardhë | 906 | | |
| | | | | 116 | Zall-Reç | 777 | | |
| | | | | | | | | |
| 5 | Durrës | 16 | KRUJË | 117 | Krujë | 12,874 | 59,320 | 20 |
| | | | | 118 | Fushë - Krujë | 19,017 | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 119 | Bubq | 6,358 | | |
| | | | | 120 | Cudhi | 2,262 | | |
| | | | | 121 | Thumanë | 11,645 | | |
| | | | | 122 | Nikël | 7,164 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 17 | DURRËS | 123 | Manëz | 8,398 | 67,355 | 21 |
| | | | | 124 | Sukth | 19,671 | | |
| | | | | 125 | Ishëm | 6,414 | | |
| | | | | 126 | Katundi i ri | 11,489 | | |
| | | | | 127 | Rrashbull | 21,383 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 128 | Durrës (zona QV 1408 deri 1424, zona QV 1458, zona QV 1459, zona QV 1463, zona QV 1467 deri 1470) | 164,188 | 54,103 | 22 |
| | | | | | Durrës (zona QV 1429, zona QV1433, zona QV 1443, zona QV 1444, zona QV 1446 deri 1451, zona QV 1461, zona QV1462, zona 1471 deri 1482, zona QV 1484 deri 1494, zona QV 1501, zona 1503 dhe zona QV 1504) | | 56,307 | 23 |
| | | | | | Durrës (zona QV 1425 deri 1428, zona QV1430 deri 1432, zona QV 1434 deri 1442, zona QV 1452 deri 1457, zona QV 1460, zona QV 1464. zona QV 1465, zona QV 1483 dhe zona QV 1495 deri 1500) | | 53,778 | 24 |
| | | | | | | | | |
| | | 18 | SHIJAK | 129 | Shijak | 10,390 | 33,882 | 25 |
| | | | | 130 | Gjepalaj | 4,479 | | |
| | | | | 131 | Maminas | 5,652 | | |
| | | | | 132 | Xhafzotaj | 13,361 | | |
| | | | | | | | | |
| 6 | Tiranë | 19 | VORË | 133 | Vorë | 15,025 | 27,442 | 26 |
| | | | | 134 | Bërxull | 7,307 | | |
| | | | | 135 | Prezë | 5,110 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 20 | KAMËZ | 136 | Kamëz | 60,432 | 60,432 | 27 |
| | | | | | | | | |
| | | | | 137 | Paskuqan | 29,251 | 29,251 | 28 |
| | | | | | | | | |
| | | 21 | TIRANË | 138 | Baldushk | 4,041 | 44,905 | 29 |
| | | | | 139 | Kashar | 17,680 | | |
| | | | | 140 | Ndroq | 6,893 | | |
| | | | | 141 | Petrelë | 4,884 | | |
| | | | | 142 | Pezë | 4,290 | | |
| | | | | 143 | Vaqarr | 7,117 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 144 | Bërzhitë | 4,381 | 40,467 | 30 |
| | | | | 145 | Dajt | 10,578 | | |
| | | | | 146 | Farkë | 9,213 | | |
| | | | | 147 | Krrabë | 2,298 | | |
| | | | | 148 | Shëngjergj | 2,104 | | |
| | | | | 149 | Zall-Bastar | 3,961 | | |
| | | | | 150 | Zall-Herr | 7,932 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 151 | Njësia Bashkiake Tiranë1 | 40,956 | 40,956 | 31 |
| | | | | 152 | Njësia Bashkiake Tiranë2 | 63,498 | 63,498 | 32 |
| | | | | 153 | Njësia Bashkiake Tiranë3 | 35,975 | 35,975 | 33 |
| | | | | 154 | Njësia Bashkiake Tiranë4 | 50,081 | 50,081 | 34 |
| | | | | 155 | Njësia Bashkiake Tiranë5 | 68,046 | 68,046 | 35 |
| | | | | 156 | Njësia Bashkiake Tiranë6 | 52,548 | 52,548 | 36 |
| | | | | 157 | Njësia Bashkiake Tiranë7 | 56,875 | 56,875 | 37 |
| | | | | 158 | Njësia Bashkiake Tiranë8 | 33,522 | 33,522 | 38 |
| | | | | 159 | Njësia Bashkiake Tiranë9 | 48,724 | 48,724 | 39 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 160 | Njësia Bashkiake Tiranë10 | 24,377 | 24,377 | 40 |
| | | | | 161 | Njësia Bashkiake Tiranë11 | 49,577 | 49,577 | 41 |
| | | | | | | | | |
| | | 22 | KAVAJË | 162 | Kavajë | 31,239 | 60,004 | 42 |
| | | | | 163 | Golem | 9,143 | | |
| | | | | 164 | Helmas | 3,692 | | |
| | | | | 165 | Luz i Vogël | 7,690 | | |
| | | | | 166 | Synej | 8,240 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 23 | RROGOZHINË | 167 | Rrogozhinë | 8,826 | 30,167 | 43 |
| | | | | 168 | Sinaballaj | 1,327 | | |
| | | | | 169 | Gosë | 6,333 | | |
| | | | | 170 | Kryevidh | 6,787 | | |
| | | | | 171 | Lekaj | 6,894 | | |
| | | | | | | | | |
| 7 | Elbasan | 24 | PEQIN | 172 | Peqin | 6,911 | 28,469 | 44 |
| | | | | 173 | Karinë | 1,431 | | |
| | | | | 174 | Gjocaj | 5353 | | |
| | | | | 175 | Pajovë | 6,553 | | |
| | | | | 176 | Përparim | 4,149 | | |
| | | | | 177 | Shezë | 4,072 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 25 | BELSH | 178 | Belsh | 10,740 | 24,240 | 45 |
| | | | | 179 | Rrasë | 1,733 | | |
| | | | | 180 | Fierzë | 3,192 | | |
| | | | | 181 | Grekan | 3,735 | | |
| | | | | 182 | Kajan | 4,840 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 26 | CËRRIK | 183 | Cërrik | 11,660 | 35,117 | 46 |
| | | | | 184 | Gostimë | 9,492 | | |
| | | | | 185 | Klos | 3,098 | | |
| | | | | 186 | Mollas | 5,647 | | |
| | | | | 187 | Shalës | 5,220 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 27 | ELBASAN | 188 | Bradashesh | 9,772 | 59,226 | 47 |
| | | | | 189 | Gracen | 1,769 | | |
| | | | | 190 | Funar | 2,335 | | |
| | | | | 191 | Gjergjan | 5,900 | | |
| | | | | 192 | Gjinar | 3,662 | | |
| | | | | 193 | Zavalinë | 1,451 | | |
| | | | | 194 | Labinot-Fushë | 4,737 | | |
| | | | | 195 | Labinot-Mal | 4,050 | | |
| | | | | 196 | Papër | 6,755 | | |
| | | | | 197 | Shirgjan | 7,591 | | |
| | | | | 198 | Shushicë | 7,906 | | |
| | | | | 199 | Tregan | 3,298 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 200 | Elbasan (zona QV 2300 deri 2323, zona QV 2327, zona QV 2328) | 99,848 | 34,897 | 48 |
| | | | | | Elbasan (zona QV 2356 deri 2378) | | 32,608 | 49 |
| | | | | | Elbasan (zona QV 2329 deri 2355) | | 32,343 | 50 |
| | | | | | | | | |
| | | 28 | GRAMSH | 201 | Gramsh | 10,455 | 27,258 | 51 |
| | | | | 202 | Kushovë | 867 | | |
| | | | | 203 | Skënderbegas | 1,466 | | |
| | | | | 204 | Kodovjat | 2,442 | | |
| | | | | 205 | Lenie | 876 | | |
| | | | | 206 | Kukur | 2,309 | | |
| | | | | 207 | Pishaj | 4,961 | | |
| | | | | 208 | Poroçan | 1,238 | | |
| | | | | 209 | Sult | 978 | | |
| | | | | 210 | Tunjë | 1,666 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 29 | LIBRAZHD | 211 | Librazhd | 7,916 | 32,590 | 52 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 212 | Stëblevë | 1,035 | | |
| | | | | 213 | Hotolisht | 5,108 | | |
| | | | | 214 | Lunik | 2,697 | | |
| | | | | 215 | Orenjë | 3,728 | | |
| | | | | 216 | Polis | 3,833 | | |
| | | | | 217 | Qendër-Librazhd | 8,273 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 30 | PRRENJAS | 218 | Prrenjas | 6,670 | 24,331 | 53 |
| | | | | 219 | Qukës | 7,793 | | |
| | | | | 220 | Rajcë | 7,719 | | |
| | | | | 221 | Stravaj | 2,149 | | |
| | | | | | | | | |
| 8 | Fier | 31 | LUSHNJË | 222 | Allkaj | 4,830 | 56,596 | 54 |
| | | | | 223 | Ballagat | 2,799 | | |
| | | | | 224 | Bubullimë | 5,675 | | |
| | | | | 225 | Dushk | 8,763 | | |
| | | | | 226 | Fier Shegan | 7,222 | | |
| | | | | 227 | Golem | 5,891 | | |
| | | | | 228 | Hysgjokaj | 2,589 | | |
| | | | | 229 | Karbunarë | 4,166 | | |
| | | | | 230 | Kolonjë | 6,596 | | |
| | | | | 231 | Krutje | 8,065 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 232 | Lushnjë | 43,681 | 43,681 | 55 |
| | | | | | | | | |
| | | 32 | DIVJAKË | 233 | Divjakë | 10,798 | 40,729 | 56 |
| | | | | 234 | Grabian | 4,776 | | |
| | | | | 235 | Gradishtë | 8,434 | | |
| | | | | 236 | Remas | 5,021 | | |
| | | | | 237 | Tërbuf | 11,700 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 33 | FIER | 238 | Cakran | 12,346 | 75,248 | 57 |
| | | | | 239 | Dërmenas | 9,654 | | |
| | | | | 240 | Frakull | 7,899 | | |
| | | | | 241 | Levan | 13,252 | | |
| | | | | 242 | Libofshë | 8,238 | | |
| | | | | 243 | Portëz | 8,523 | | |
| | | | | 244 | Qendër | 9,343 | | |
| | | | | 245 | Topojë | 5,993 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 246 | Fier | 71,787 | 79,734 | 58 |
| | | | | 247 | Mbrostar Ura | 7,947 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 34 | PATOS | 248 | Patos | 24,742 | 33,571 | 59 |
| | | | | 249 | Ruzhdie | 2,383 | | |
| | | | | 250 | Zharrëz | 6,446 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 35 | ROSKOVEC | 251 | Roskovec | 6,803 | 23,958 | 60 |
| | | | | 252 | Kuman | 6,308 | | |
| | | | | 253 | Kurjan | 3,984 | | |
| | | | | 254 | Strum | 6,863 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 36 | MALLAKASTËR | 255 | Ballsh | 9,532 | 32,798 | 61 |
| | | | | 256 | Aranitas | 3,294 | | |
| | | | | 257 | Ngraçan | 745 | | |
| | | | | 258 | Fratar | 3,791 | | |
| | | | | 259 | Selitë | 1,170 | | |
| | | | | 260 | Greshicë | 1,510 | | |
| | | | | 261 | Hekal | 3,601 | | |
| | | | | 262 | Kutë | 2,555 | | |
| | | | | 263 | Qendër Dukas | 6,600 | | |
| | | | | | | | | |
| 9 | Berat | 37 | URA-VAJGURORE | 264 | Ura-Vajgurore | 9,052 | 29,631 | 62 |
| | | | | 265 | Cukalat | 3,182 | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 266 | Kutalli | 9,650 | | |
| | | | | 267 | Poshnje | 7,747 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 38 | KUCOVË | 268 | Kuçovë | 24,154 | 43,628 | 63 |
| | | | | 269 | Kozare | 6,112 | | |
| | | | | 270 | Lumas | 5,293 | | |
| | | | | 271 | Perondi | 8,069 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 39 | BERAT | 272 | Berat | 50,952 | 77,997 | 64 |
| | | | | 273 | Otllak | 11,087 | | |
| | | | | 274 | Roshnik | 2,984 | | |
| | | | | 275 | Sinjë | 3,971 | | |
| | | | | 276 | Velabisht | 9,003 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 40 | POLICAN | 277 | Polican | 6,592 | 14,008 | 65 |
| | | | | 278 | Tërpan | 1,965 | | |
| | | | | 279 | Vërtop | 5,451 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 41 | SKRAPAR | 280 | Çorovodë | 5,062 | 15,924 | 66 |
| | | | | 281 | Bogovë | 2,524 | | |
| | | | | 282 | Çepan | 858 | | |
| | | | | 283 | Gjerbës | 1,003 | | |
| | | | | 284 | Zhepë | 832 | | |
| | | | | 285 | Potom | 852 | | |
| | | | | 286 | Qendër-Skrapar | 3,195 | | |
| | | | | 287 | Leshnje | 563 | | |
| | | | | 288 | Vëndreshë | 1,035 | | |
| | | | | | | | | |
| 10 | KORÇË | 42 | POGRADEC | 289 | Pogradec | 30,982 | 69,858 | 67 |
| | | | | 290 | Buçimas | 13,323 | | |
| | | | | 291 | Çërravë | 7,371 | | |
| | | | | 292 | Dardhas | 2,671 | | |
| | | | | 293 | Udenisht | 5,708 | | |
| | | | | 294 | Proptisht | 4,663 | | |
| | | | | 295 | Trebinjë | 2,589 | | |
| | | | | 296 | Velçan | 2,551 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 43 | MALIQ | 297 | Maliq | 6,170 | 48,685 | 68 |
| | | | | 298 | Gorë | 1,877 | | |
| | | | | 299 | Moglicë | 1,240 | | |
| | | | | 300 | Libonik | 10,655 | | |
| | | | | 301 | Pirg | 7,365 | | |
| | | | | 302 | Pojan | 13,397 | | |
| | | | | 303 | Vreshtas | 7,981 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 44 | PUSTEC | 304 | Pustec | 4,301 | 4,301 | 69 |
| | | | | | | | | |
| | | 45 | DEVOLL | 305 | Bilisht | 8,047 | 33,431 | 70 |
| | | | | 306 | Hoçisht | 5,508 | | |
| | | | | 307 | Miras | 8,127 | | |
| | | | | 308 | Progër | 4,712 | | |
| | | | | 309 | Qendër Bilisht | 7,037 | | |
| | | | | | | | | |
| | | 46 | KORÇË | 310 | Drenovë | 8,741 | 34,000 | 71 |
| | | | | 311 | Mollaj | 5,063 | | |
| | | | | 312 | Vithkuq | 1,980 | | |
| | | | | 313 | Qendër Bulgarec | 10,832 | | |
| | | | | 314 | Voskop | 4,593 | | |
| | | | | 315 | Voskopojë | 2,056 | | |
| | | | | 316 | Lekas | 735 | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | 317 | Korçë | 72,909 | 72,909 | 72 |
| | | | | | | | | |
| | | 47 | KOLONJË | 318 | Ersekë | 5,699 | 16,123 | 73 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 319 | Leskovik | 2,151 | | |
| | | | | 320 | Barmash | 576 | | |
| | | | | 321 | Qendër Leskovik | 587 | | |
| | | | | 322 | Mollas | 2,668 | | |
| | | | | 323 | Çlirim | 590 | | |
| | | | | 324 | Qendër Ersekë | 532 | | |
| | | | | 325 | Novoselë | 3,320 | | |
| | | | | 326 | Përmet | 8,350 | | |
| | | | | 327 | Çarçovë | 2,401 | | |
| | | 48 | PËRMET | 328 | Petran | 2,507 | 16,483 | 74 |
| | | | | 329 | Qendër Piskovë | 2,663 | | |
| | | | | 330 | Frashër | 562 | | |
| | | | | 331 | Këlcyrë | 4,022 | | |
| | | 49 | KËLCYRË | 332 | Ballaban | 1,699 | 9,809 | 75 |
| | | | | 333 | Dëshnicë | 1,954 | | |
| | | | | 334 | Sukë | 2,134 | | |
| | | | | 335 | Memaliaj | 5,553 | | |
| | | | | 336 | Memaliaj Fshat | 2,144 | | |
| | | 50 | MEMALIAJ | 337 | Krahës | 3,115 | 16,770 | 76 |
| | | | | 338 | Qesarat | 1,942 | | |
| | | | | 339 | Luftinjë | 2,857 | | |
| | | | | 340 | Buz | 1,159 | | |
| 11 | Gjirokastër | | | 341 | Tepelenë | 6,478 | | |
| | | 51 | TEPELENË | 342 | Qendër Tepelenë | 4,180 | 12,816 | 77 |
| | | | | 343 | Kurvelesh | 1,151 | | |
| | | | | 344 | Lopëz | 1,007 | | |
| | | | | 345 | Gjirokastër | 27,636 | | |
| | | | | 346 | Cepo | 3,600 | | |
| | | | | 347 | Picar | 1,613 | | |
| | | 52 | GJIROKASTËR | 348 | Lazarat | 2,686 | 42,633 | 78 |
| | | | | 349 | Lunxhëri | 4,321 | | |
| | | | | 350 | Antigonë | 1,394 | | |
| | | | | 351 | Odrie | 1,383 | | |
| | | | | 352 | Libohovë | 4,321 | | |
| | | 53 | LIBOHOVË | 353 | Qendër Libohovë | 1,383 | 7,098 | 79 |
| | | | | 354 | Zagorie | 1,394 | | |
| | | | | 355 | Dropull i Poshtëm | 8,176 | | |
| | | 54 | DROPULL | 356 | Dropull i Sipërm | 9,180 | 20,074 | 80 |
| | | | | 357 | Pogon | 2,718 | | |
| | | | | 358 | Orikum | 8,908 | | |
| | | | | 359 | Novoselë | 12,778 | 43,372 | 81 |
| | | | | 360 | Qendër Vlorë | 14,452 | | |
| | | | | 361 | Shushicë | 7,234 | | |
| 12 | Vlorë | 55 | VLORË | | Vlorë (zona QV 4429 deri 4434, zona QV 4436, zona QV 1437, zona QV 4443, zona QV 4456-4459, zona QV 4494, zona 4495, zona QV 4499 deri 4506 dhe zona QV 4510) | | 35,149 | 82 |
| | | | | 362 | Vlorë (zona QV 4427, zona QV 4428, zona QV 4438 deri 4442, zona QV 4444 deri 4455, zona QV 4482 deri 4487, zona QV 4507 deri 4509) | 110,495 | 38,671 | 83 |
| | | | | | Vlorë (zona QV 4460 deri 4481, zona QV 4488 deri 4493, zona QV 4496 deri 4498) | | 36,675 | 84 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 56 | SELENICË | 363 | Selenicë | 5,426 | 27,179 | 85 |
| | | 364 | Armen | 5,148 | | |
| | | 365 | Brataj | 3,693 | | |
| | | 366 | Kotë | 5,161 | | |
| | | 367 | Sevaster | 2,374 | | |
| | | 368 | Vllahinë | 5,377 | | |
| 57 | HIMARË | 369 | Himarë | 11,271 | 22,336 | 86 |
| | | 370 | Horë - Vranisht | 3,034 | | |
| | | 371 | Lukovë | 8,031 | | |
| 58 | DELVINË | 372 | Delvinë | 12,111 | 15,174 | 87 |
| | | 373 | Vergo | 3,063 | | |
| 59 | SARANDË | 374 | Sarandë | 36,291 | 43,166 | 88 |
| | | 375 | Ksamil | 6,875 | | |
| 60 | FINIQ | 376 | Aliko | 4,890 | 29,585 | 89 |
| | | 377 | Dhivër | 5,525 | | |
| | | 378 | Finiq | 4,990 | | |
| | | 379 | Livadhja | 8,736 | | |
| | | 380 | Mesopotam | 5,444 | | |
| 61 | KONISPOL | 381 | Konispol | 2,424 | 10,976 | 90 |
| | | 382 | Markat | 2,431 | | |
| | | 383 | Xarrë | 6,121 | | |
| | | | **Gjithsej** | **3,382,295** | **3,382,295** | **90** |

**DEKRET**
**Nr. 9042, datë 6.4.2015**

## PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjin nr. 31/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 31/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bujar Nishani**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 154 lekë